



KCSS

Kosovar Centre for Security Studies

**PËRMBLEDHJE E
SHKURTËR E
POLITIKAVE**

Luftimi i dezinformimit dhe radikalizimit në Kosovë

Veprime politike për qeverinë, mediat dhe partnerët ndërkombëtarë për të përforcuar qëndrueshmëri ndaj dezinformatave që synojnë marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë

15 dhjetor 2025, Prishtina

I PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Dezinformimi dhe radikalizimi etno-politik mbeten probleme të vazhdueshme në Kosovë, duke prekur si komunitetin shqiptar ashtu edhe atë serb dhe duke minuar besimin në institucione dhe në media. Hulumtimi dhe konsultimet në nivelin lokal të projektit DISRUPT tregojnë se dezinformimi përforcohet nga standardet e dobëta editoriale, mungesa e llogaridhënies dhe kapacitetet e kufizuara për verifikimin e fakteve. Rënia e cilësisë së informimit nga ana e mediave lokale dhe varësia nga burime të centralizuara ose të huaja i kanë lënë komunitetet të ekspozuara ndaj narrativave me qëllime të synuara, veçanërisht gjatë krizave politike.

Sfidat më urgjente janë manipulimi mediatik dhe mungesa e transparencës, cenueshmëria e të rinjve dhe e brezave më të vjetër ndaj informacionit të rremë, rënia e cilësisë së informimit nga mediat lokale dhe e burimeve të besueshme të informacionit, reagimi i pamjaftueshëm institucional—veçanërisht në komunikimin dygjuhësh—si dhe polarizimi politik. Këto sfida janë të ndërlikura dhe kërkojnë veprim të koordinuar nga qeveria, komunitat, mediat, shoqëria civile dhe partnerët ndërkombëtarë.

Konsultimet e fundit nxjerrin në pah rëndësinë e emërimit të zëdhënësve në të dy gjuhët zyrtare—që pra për gjuhën serbe në institucionet qendrore dhe të gjuhës shqipe në komunitat me shumicë serbe—për të përmirësuar komunikimin dhe për të ndërtuar besim ndërmjet komuniteteve. Gjithashtu, ekziston një nevojë e qartë për konferenca shtypi më të shpeshta dhe të drejtpërdrejta, si dhe për angazhim të drejtpërdrejtë me publikun, në vend që të mbështetemi vetëm në deklaratat të shkruara. Këto hapa mund të ndihmojnë në zvogëlimin e paqartësive, sqarimin e pozicioneve zyrtare dhe kundërveprimin ndaj përhapjes së narrativave të rreme.

Për të adresuar këto çështje, ky dokument rekomandon krijimin dhe financimin e njësisë të pavarura dygjuhëshe për verifikimin e fakteve në nivel kombëtar dhe komunal, forcimin e standardeve editoriale dhe të llogaridhënies në media, mbështetjen e iniciativave mediatike bazuar në komunitet dhe programeve të edukimit mediatik, si dhe integrimin e masave kundër dezinformimit në strategjitë e sigurisë kombëtare dhe bashkëpunimit rajonal. BE-ja, OSBE-ja dhe partnerët e tjerë ndërkombëtarë duhet të ofrojnë raportime të dedikuara dhe të rregullta mbi dialogun për normalizim dhe çështjeve të dezinformimit ndëretnik, si dhe të mbështesin mekanizmat lokale të monitorimit. Këto veprime janë të nevojshme për të zvogëluar ndikimin e dezinformimit, për të përmirësuar besimin e publikut dhe për të mbështetur përparimin e Kosovës drejt integritimit në BE dhe stabilitetit rajonal.

2 GJENDJA E ÇËSHTJEVE

Mjedisi i informacionit në Kosovë po kalon në një transformim të thellë, i formësuar si nga dinamikat e brendshme ashtu dhe presionet e jashtme. Dezinformimi ka evoluar nga keqinformimet sporadike në një sfidë të vazhdueshme dhe sistematike që ndikon drejtpërdrejt në

perspektivat e vendit për integrim evropian dhe bashkëpunim rajonal në fushën e sigurisë. Vitet e fundit kanë treguar një rritje të ndjeshme të sofistikut dhe përhapjes së fushatave të dezinformimit, me aktorë të huaj—veçanërisht nga Rusia dhe Serbia—që shfrytëzojnë aktivisht pakënaqësitë lokale dhe tensionet e pazgjidhura historike. Këto fushata nuk kufizohen vetëm në incidente të izoluara; përkundrazi ato janë të ndërthurura në jetën e përditshme, duke ndikuar në perceptimet e publikut, diskutimin politik dhe marrëdhëniet ndëretnike.

Peizazhi mediatik në Kosovë është jashtëzakonisht i fragmentuar dhe i polarizuar. Platformat online, si Telegram, Facebook dhe TikTok, janë bërë fushëbetejat kryesore për narrativat debatuese, shpesh duke përforcuar përmbajtje sensacionale dhe emocionalisht të ngarkuara. Ndërkohë, mediat tradicionale përballen me rënie të burimeve, pavarësisht editoriale dhe transparencës financiare. Mbyllja e mediave lokale dhe mungesa e rrjeteve të forta të korrespondentëve kanë bërë që shumë komunitete të varen nga burime të centralizuara ose të huaja informacioni, të cilat shpesh nuk kanë kuptim kontekstual dhe llogaridhënie. Ky vakum është mbushur nga media partiake dhe influencuesit e mediave sociale, përmbajtja e të cilëve shpesh përshtatet për të përforcuar frikën dhe përçarjet ekzistuese.

Reagimet institucionale ndaj dezinformimit mbeten të pabarabarta dhe, në shumë raste, të pamjaftueshme. Megjithëse ka pasur përpjekje për të zhvilluar strategji kombëtare për sigurinë kibernetike dhe integritetin e informacionit, këto masa shpesh janë të fragmentuara dhe u mungon qasja gjithëpërfshirëse dhe në të dy gjuhët që është e nevojshme për të adresuar realitetet e shoqërisë shumetnike të Kosovës. Mungesa e ekipeve të reagimit të shpejtë, e njëjstëve të dedikuara për verifikimin e fakteve dhe e strategjive gjithëpërfshirëse të komunikimit ka lejuar përhapjen e dezinformimit, veçanërisht gjatë periudhave të krizave politike ose të tensioneve të shtuara ndëretnike. Mungesa e besimit në institucionet publike e përkeqëson më tej problemin, pasi qytetarët gjithnjë e më shumë drejtohen drejt burimeve alternative të informacionit që mund të mos i përmbahen standardeve profesionale.

Duke shikuar në drejtim të 12–24 muajve të ardhshëm, Kosova do përballet me një udhëkryq kritik. Ndërveprimi ndërmjet cënueshmërive të brendshme dhe fushatave të ndikimit të jashtëm do të vazhdojë të formësojë rrjedhën e marrëdhënieve ndëretnike dhe integrimin e vendit në kornizat evropiane dhe rajonale. Koncepti i integritimit operacional—bashkëpunim i synuar në nivel agjencish ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor (BP 6)—ofron një rrugë drejt qëndrueshmërisë, por vetëm nëse shoqërohet me reforma të koordinuara, masa për ndërtimin e besimit dhe iniciativa gjithëpërfshirëse. Mosveprimi me vendosmëri rrezikon thellimin e polarizimit dhe minimin e vetë themelet të qeverisjes demokratike dhe kohezionit shoqëror. Anasjelltas, ndërhyrjet strategjike dhe bashkëpunimi ndërsektorial mund t'i shndërrojnë këto sfida në mundësi për normalizim gradual dhe paqe të qëndrueshme.

3 SFIDAT

Adresimi i peizazhit kompleks të dezinformimit dhe radikalizimit etno-politik në Kosovë kërkon një njohje të qartë të pengesave më urgjente. Secila nga sfidat e paraqitura më poshtë bazohet në gjetjet e projektit DISRUPT dhe pasqyron përvojat e përditshme të komuniteteve, institucioneve dhe aktorëve të interesit në mbarë vendin.

Manipulim i përhapur mediatik dhe mungesë e llogaridhënies. Një nga sfidat më të rëndësishme është manipulimi i gjerësisht i përhapur i informacionit nga mediat, veçanërisht në sferën online. Standardet editoriale shpesh janë të dobëta dhe mekanizmat për korrigjimin e keqinformimit janë pothuajse nuk ekzistojnë, sidomos në nivel lokal. Paqartësia financiare dhe mungesa e transparencës lidhur me në pronësinë e mediave e gërryejnë më tej besimin e publikut, duke i lënë qytetarët të cenueshëm ndaj raportimeve sensacionale dhe të njëanshme. Ky mjedis mundëson përhapjen e shpejtë të dezinformimit, duke minuar përpjekjet për të nxitur debat publik të informuar dhe kohezion shoqëror.

Cenueshmëria e të rinjve dhe e gjeneratave më të vjetër. Ndikimi i dezinformimit ndihet thellësisht si te brezat e rinj ashtu edhe te ata më të vjetër. Të rinjtë shpesh ekspozohen ndaj narrativave etno-politike emocionalisht të ngarkuara në rrjetet sociale, të cilat mund të formësojnë qëndrimet dhe sjelljet e tyre në mënyra që përforcojnë ndarjet dhe mosbesimin. Në të njëjtën kohë, gjeneratat më të vjetër shpesh u mungojnë aftësitë ose burimet për të verifikuar besueshmërinë e burimeve të informacionit, duke i bërë ata të cenueshëm ndaj manipulimit. Hendeku ndërmjet gjeneratave në edukimin mediatik dhe qëndrueshmërinë ndaj dezinformimit paraqet një sfidë të veçantë për hartuesit e politikave dhe edukatorët.

Rënia e mediave lokale dhe e ekosistemeve të informacionit. Mbyllja e shtëpive mediatike lokale dhe mungesa e mbështetjes komunale për gazetarinë bazuar në komunitet kanë krijuar një vakum në ekosistemin e informacionit. Komunitetet janë gjithnjë e më të varura nga burime të centralizuara ose të huaja, të cilat mund të mos pasqyrojnë realitetet ose prioritetet lokale. Kjo rënie e raportimit të besueshëm dhe të kontekstualizuar dobëson aftësinë e qytetarëve për t'u angazhuar në mënyrë kuptimplote me çështjet publike dhe kontribuon në përhapjen e narrativave përçarëse.

Reagim institucional i pamjaftueshëm dhe verifikim i fakteve në të dy gjuhët. Institucionet qeveritare dhe ato të pavarura kanë hasur vështirësi në zhvillimin e përgjigjeve efektive ndaj krizës së dezinformimit. Mungesa e ekipeve të reagimit të shpejtë, e njësisve për verifikimin e fakteve në të dy gjuhët dhe e strategjive gjithëpërfshirëse të komunikimit ka lejuar përhapjen e pakontrolluar të narrativave të rreme. Pa masa të koordinuara dhe proaktive, si komuniteti shqiptar ashtu edhe ai serb mbeten të ekspozuar ndaj fushatave të synuara që shfrytëzojnë ndarjet gjuhësore dhe kulturore.

Polarizimi politik dhe instrumentalizimi i tensioneve etnike. Aktorët politikë, si vendorë ashtu edhe të huaj, vazhdojnë ta shfrytëzojnë dezinformimin për përfitime strategjike.

Instrumentalizimi i tensioneve etnike shërben për konsolidimin e pushtetit, delegjitimimin e kundërshtarëve dhe nxitjen e përçarjeve shoqërore. Neglizhenca institucionale ndaj përfshirjes dhe të drejtave gjuhësore—siç është boshllëku i tejzgjatur i pozitës së Komisionerit të Gjuhëve—dërgon sinjale negative dhe përforcon perceptimet e marginalizimit. Ky mjedis polarizimi jo vetëm që minon besimin në institucionet publike, por edhe e ndërlikon përpjekjen për të çuar përpara procesin e normalizimit dhe integritit.

4 REKOMANDIMET

4.1 PËR INSTITUCIONET KOMBËTARE (QEVERIA, KOMUNAT, INSTITUCIONET E PAVARURA)

- ⇒ **Komunikoni qartë dhe në mënyrë proaktive.** Ndryshimi i qasjes nga deklaratat vetëm me shkrim në konferenca të rregullta dhe të drejtpërdrejta për shtyp—veçanërisht gjatë krizave ose zhvillimeve të ndjeshme, Kjo lejon parashtrimin e pyetjeve të drejtpërdrejta, zvogëlon paqartësitë dhe ndërton besimin e publikut. Siguroni që të gjitha komunikimet zyrtare të jenë koncize, faktike dhe të shmangin gjuhën e paqartë ose të politizuar. Caktoni zëdhënës të trajnuar në komunikimin e krizave dhe në ndjeshmërinë ndëretnike.
- ⇒ **Krijimi i ekipeve të reagimit të shpejtë dhe të verifikimit të fakteve.** Krijoni ekipe të dedikuara, dygjuhëshe të reagimit të shpejtë brenda ministrive dhe komunave për të adresuar dezinformimin në zhvillim në kohë reale, veçanërisht në rrjetet sociale. Financimi i njësi të pavarura, multietnike për verifikimin e fakteve në nivel qendror dhe komunal, me mandate të qarta dhe raportim publik.
- ⇒ **Emërimi i zëdhënësve në të dy gjuhët.** Siguroni që të gjitha ministritë dhe agjencitë e nivelit qendror qeverisës të kenë zëdhënës që flasin gjuhën serbe dhe që angazhohen në mënyrë proaktive me mediat dhe komunitetet në gjuhën serbe. Në komunat me shumicë serbe, emëroni zëdhënës që flasin gjuhën shqipe për të lehtësuar komunikimin me mediat dhe banorët në gjuhën shqipe. Të dy rolet duhet të jenë të pranishme, të qasshme dhe të marrin pjesë rregullisht në konferenca për shtyp dhe aktivitete informuese në kontakt me komunitetin.
- ⇒ **Institucionalizimi i monitorimit dhe transparencës.** Kërkoni nga të gjitha ministritë dhe komunat të publikojnë raporte të rregullta (p.sh., tremujore) të transparencës mbi aktivitetet e tyre të komunikimit, përfshirë përgjigjet ndaj dezinformimit dhe informimin e komuniteteve pakicë.
- ⇒ **Mbështetja e mediave lokale dhe e edukimit mediatic.** Ofrimi i granteve ose mbështetjes teknike për rimëkëmbjen e mediave lokale, veçanërisht në komunat shumetnike. Integroni module të edukimit mediatic në kurrikulat shkollore dhe në programet komunitare, duke targetuar si të rinjtë ashtu edhe brezat më të vjetër.

- ⇒ **Forcimi i kuadrit ligjor dhe rregullator.** Rishikimi dhe përditësimi i ligjeve për mediat dhe informacionin për të përfshirë dënime të qarta për dezinformim të qëllimshëm, gjuhën e urrejtjes dhe moskorrigjimin e raportimeve të rreme.

4.2 PËR MEDIAT DHE SHOQËRINË CIVILE

- ⇒ **Nisja e iniciativave të përbashkëta për monitorim dhe raportim.** Shoqata e Gazetarëve të Kosovës, në partneritet me shoqërinë civile, duhet të krijojë një mekanizëm të rregullt monitorimi për dezinformimin ndëretnik. Publikoni raporte mujore ose tremujore që ndjekin trendet, incidentet dhe reagimet. Zhvilloni një platformë të përbashkët online ku rastet e verifikuara të dezinformimit mund të raportohen, analizohen dhe diskutohen publikisht. Nisni koalicionet e përbashkëta të mediave shqiptare dhe serbe për monitorimin e mediave, për të ndjekur dhe raportuar publikisht trendet e dezinformimit në të gjitha hapësirat gjuhësore.
- ⇒ **Nxitja e gazetarisë bashkëpunuese.** Inkurajoni koalicionet e gazetarëve shqiptarë dhe serbë të për artikuj hulumtues në bashkëautorësi, të ndajnë burime dhe të kryejnë verifikime të përbashkëta të fakteve. Organizoni punëtorë dhe shkëmbime të rregullta për gazetaret mbi standardet profesionale, raportimin etik dhe komunikimin gjatë krizave.
- ⇒ **Rritja e angazhimit dhe edukimit publik.** Organizoni forume të hapura, tubime me qytetarë dhe fushata të edukimit mediatic në komunitetet më të prekura nga dezinformimi, me pjesëmarrjen e liderëve lokalë, edukatorëve dhe grupeve rinore. Organizatat e shoqërisë civile duhet të zhvillojnë udhëzues dhe vegla për qytetarët mbi mënyrat e identifikimit dhe raportimit të dezinformimit.
- ⇒ **Avokimi për llogaridhënie editoriale.** Shtëpitë mediatike duhet të miratojnë dhe të shfaqin publikisht udhëzime editoriale të qarta, duke përfshirë kërkesat për verifikim nga burime të shumta dhe korrigjime. Krijoni role ombudsmani ose panele të pavarura shqyrtimi brenda organizatave kryesore mediatike për të trajtuar ankesat dhe për të siguruar llogaridhënie.

4.3 PËR BE-NË DHE PARTNERËT NDËRKOMBËTARË (BE, OSBE, OKB, DONATORË)

- ⇒ **Ofrimi i raportimit të dedikuar dhe të rregullt.** BE-ja dhe OSBE-ja duhet të publikojnë raporte publike periodike (p.sh., gjysmëvjetore) mbi dialogun për normalizimin e marrëdhënieve, me një seksion të dedikuar për rolin dhe ndikimin e dezinformimit dhe narrativave ndëretnike. Mbështetni zhvillimin e një paneli apo indeksi rajonal për të ndjekur incidentet e dezinformimit, reagimet dhe tendencat në Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor.
- ⇒ **Financimi dhe lehtësimi i mekanizmave të monitorimit.** Ofroni mbështetje teknike dhe financiare për monitorimin e pavarur të dezinformimit ndëretnik, përfshirë ndërtimin e kapaciteteve për verifikuesit lokalë të fakteve dhe organizatat monitoruese të

mediave. Inkurajoni organizatat ndërkombëtare të bashkëpunojnë me institucionet lokale për misione të përbashkëta monitorimi dhe brifingjet publike.

- ⇒ **Forcimi i komunikimit strategjik.** Misionet e BE-së dhe ato ndërkombëtare në Kosovë duhet të rrisin frekuencën e konferencave të drejtpërdrejta për shtyp dhe sesioneve me pyetje dhe përgjigje, veçanërisht gjatë periudhave të ndjeshme, për të sqaruar pozicionet dhe për të kundërshtuar narrativat e rreme. Zhvilloni dhe shpërndani materiale të qarta dhe të aksesueshme që shpjegojnë procesin e normalizimit të marrëdhënieve, hapat e integritit në BE dhe rreziqet e dezinformimit.
- ⇒ **Mbështetja e inovacionit në media dhe shoqëri civile.** Financoji projekte pilote për formate të reja mediatike (p.sh, podkaste, video shpjeguese, platforma interaktive) që promovojnë mirëkuptimin ndëretnik dhe luftojnë dezinformimin. Lehtësoni vizitat për gazetarë, udhëheqës të shoqërisë civile dhe zyrtarë publikë në veri të Kosovës dhe anasjelltas për të thelluar kuptimin e kontekstit.
- ⇒ **Ofroni mbështetje teknike për Komisionin e Pavarur për Media** për të kryer auditime të rregullta të shtëpive mediatike për përputhshmërinë me standardet editoriale dhe transparencën.
- ⇒ **Mbështetni iniciativa për ndërtimin e narrativave** që promovojnë storie alternative mbi bashkëpunimin, jetën e përditshme dhe sfidat e përbashkëta, duke përdorur formate që ballafaqohen me dezinformimin në hapësirat online.